

**MARKETING & DISTRIBUTION Sh.p.k**  
**Raporti i Audituesit të Pavarur dhe**  
**Pasqyra e ndryshimeve në kapital**  
**më 7 dhjetor 2023**

## RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar: Drejtimin dhe Ortakut të Marketing & Distribution Sh.p.k.

1. Ne kemi audituar pasqyrën e bashkëngjitur të lëvizjeve në kapitalit të Marketing & Distribution Sh.p.k (Shoqëria) më 7 dhjetor 2023. Pasqyra është përgatitur nga drejtimi bazuar në parimet e kontabilitetit të zbatuara për përgatitjen e pasqyrave financiare të Shoqërisë, më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022, në përputhje me Standartet Nderkombëtare të Raportimit Financiar. Përgatitja e kësaj pasqyre është përgjegjësi e Drejtimin të Shoqërisë. Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këtë pasqyrë, duke u bazuar në auditimin tonë.
2. Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin në mënyrë të tillë, që të përfitojmë siguri të arsyeshme që pasqyra e ndryshimeve në kapital nuk përmban pasaktësi materiale. Një auditim përfshin vlerësimin, duke u bazuar në teste, të evidencave që mbështesin vlerat dhe paraqitjet në pasqyrë. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe vlerësimet e rëndësishme të bëra nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrës. Ne besojmë se auditimi jonë siguron një bazë të arsyeshme për opinionin tonë.
3. Sipas opinionit tonë, informacioni financiar në pasqyrën e ndryshimeve në kapital të Marketing & Distribution Sh.p.k. më 7 dhjetor 2023 është përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me parimet kontabël të zbatuara në përgatitjen e pasqyrave financiare të Shoqërisë në përputhje me Standardet Nderkombëtare të Kontabilitetit.
4. Ky raport është hartuar vetëm për qëllimin e zmadhimit të kapitalit të Shoqërisë dhe nuk duhet të përdoret për qëllime të tjera. Deri në datën e lëshimit të këtij raporti, zmadhimi i kapitalit nuk ishte regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
5. Pasqyrat financiare të Marketing & Distribution Sh.p.k të përgatitura në përputhje me Standardet Nderkombëtare të të Raportimit Financiar më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 janë audituar dhe raporti i audituesit daton 17 korrik 2023.

**Rezar Llukacej**  
Partner Angazhimi

Tiranë më, 9 dhjetor 2023



knowing you.

+355 44 50 42 81

Rruga "Muhamet Gjollësia",  
Godina Qendra Tregtare Ring,  
Shkalla 2, Kati 6, Ap. 6, Tirana, Albania

kreston.al

An independent member of the  
Kreston Global network



**Marketing & Distribution Sh.p.k**  
**Pasqyra e ndryshimeve në kapital**

Vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

**1. PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITALIN AKSIONAR MË 7 DHJETOR 2023**

Bazuar ne Vendimin e Asamblese se Pergjithshme se Ortakut te vetem më 7 dhjetor 2023, shoqëria Marketing & Distribution Sh.p.k. zmadhoi kapitalin me vlerë 23,509,145 lekë (njëzetëetëre milion e pesëqind e nëntë mijë e njëqind e dyzetë e pesë ) lekë.

Vlera prej 23,509,145 lekë, përbëhet nga fitimi i pashpërndarë ndër vite i shoqërisë.

	<b>Gjendja më 31 dhjetor 2022</b>	<b>Rritja/Zvogëlimi</b>	<b>Gjendja më 7 dhjetor 2023</b>
Kapitali	79,431,330	23,509,145	102,940,475
Fitimi i pashpërndarë	3,754,696,273	(23,509,145)	3,731,187,128
	<b>3,834,127,603</b>	-	<b>3,834,127,603</b>

**Marketing & Distribution Sh.p.k**  
**Pasqyra e ndryshimeve në kapital**

Vlerat janë në Lek, përveç kur shprehet ndryshe

**1. PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITALIN AKSIONAR MË 7 DHJETOR 2023 (VAZHDIM)**

Struktura e pronësisë më 31 dhjetor 2022 dhe 7 dhjetor 2023 është si në vazhdim:

Ortakët	Nr. I kuotave me 31 dhjetor 2022	%	Vlera e kuotave 31 dhjetor 2022	Nr. I kuotave me 7 dhjetor 2023	%	Vlera kuotave me 7 dhjetor 2023
Vilma Nushi	100	100%	79,431,330	100	100%	102,940,475
	<b>100</b>		<b>79,431,330</b>	<b>100</b>		<b>102,940,475</b>

Pasqyra e ndryshimeve në kapital u aprovua më 7 dhjetor 2023 nga:

**Z. Besnik Nushi**

Administrator

